

AKT THEMELIMI

I

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“ ENERIKO ” Shpk

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 25/06/2024, unë **ENERIKO ÇELAJ**, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ **ENERIKO** ” Shpk.
Kjo shoqëri themelohet në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjin Nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" me ndryshimet e mëvonshme.

Themeluesi i kompanisë

- **ENERIKO ÇELAJ**, Lindur në Vlorë, më 14/05/1994, me Nr. Id **J40514090A**

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë si më poshtë :

Investitor në fushën e ndërtimit. Aktivitet në fushën e ndërtimit, hotelerisë, shërbimeve dhe tregtisë. Në fushën e projektimit e ndërtimit të veprave të ndryshme prej murature tulle, guri, betoni, punime dheu.. Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore. Ndërtim rrugesh, punime të mirëmbajtjes në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Montimi dhe instalimi i impianteve termike të ventilimit dhe kondicionimit të ajrit. Ndërtim ura e vepra arti, ndërtim tunele rrugore-hekurudhore. Ndërtim ujësjellëskanalizime, kanale e impiante vaditje-kullimi-sillose, kulla, kulla uji etj. Gërmime, drenazhime punime në toka bujqësore etj..

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kompanisë do të jetë në një periudhë pa afat.

Neni 4:

Selia

Selia e kompanisë është në adresën: “ Lagjja Pavarësia, Zona kadastrale 8603, Nr pasurie 29/271 – N30, Vol.34, Fq 179, Kati 1, Vlorë ”.

Me të drejtë për të ndryshuar qendrën e saj dhe për të hapur degë dhe filiale të tjera në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë mund të krijojë, modifikojë apo të anultojë seli sekondare agjensi dhe përfaqësi kudo që e quan të nevojshme edhe jashtë shtetit.

Neni 5 Kapitali themeltar

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin themeltar të shoqërisë është në 1 kuotë, në përputhje me kontributet e tij si më poshtë:

Kapital financiar 100,000 lekë.

1. Ortak, Themelues: **ENERIKO ÇELAJ** zotërues i 1 (një) kuote, në masën 100 % me vlerë 100,000 Lekë.


Neni 6: Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë
Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.


Administrator i shoqërisë caktohet : **ENERIKO ÇELAJ**, Lindur në Vlorë, më 14/05/1994 , me Nr. Id , banues në Vlorë.

(Emër, Mbiemër, Firmë):

Enriko Çelaj 

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

**ORTAKU I VETËM
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ENERIKO"**

Enriko Çelaj 
Emër mbiemër (nënshkrimi)